




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Drejtoria për Kulturë në Komunën e Prishtinës
duke u mbështetur në Vendimin për Kriteret dhe procedurën e ndarjes së subvencioneve
nr. 01-091-112404 të dt. 12.05.2014, u bën

THIRRJE

organizatave që veprojnë në sektorin e kulturës të aplikojnë me projekt propozime për MBËSHTETJE VJETORE të aktiviteteve të planifikuara për vitin 2017. Të interesuarit duhet të përmbushin kriteret si në vijim:

- Të plotësojnë dhe dorëzojnë të nënshkruar formularin për aplikim, i cili mund të shkarkohet nga ueb faqja e Komunës;
- Të kenë aktivitete kulturore çdo muaj;
- Të përfundojnë realizimin e projektit deri me 31 dhjetor 2017;
- Të prezantojnë dëshmi për sigurimin e 50% të fondeve të planifikuara;
- Të dorëzojnë të gjitha dokumentet e kërkuara në formularin për aplikim.

Shpenzime të cilat nuk do të mbështeten janë ato administrative, renovime, blerje të pajisjeve, dhurata, shpërblime dhe të ngjashme.

Përparësi do të kenë projektet të cilat dëshmojnë bashkëpunim me institucione edukative dhe arsimore në Komunën e Prishtinës, përfshirje aktive të nxënësve në punëtori apo/dhe aktivitete tjera, si dhe ato që kanë treguar sukses me programe në vitet paraprake.

Projekt propozimet mund të dorëzohen në zyrën pritëse, sporteli nr.5 në Komunën e Prishtinës (objekti i vjetër) deri më **20 shkurt 2017**.

Formulari për aplikim mund të shkarkohet nga vegza: <http://kk.rks-gov.net/prishtina/Municipality/Departments/Kultures,Rinise,Sportit/Subvencionet/Subvencione/Formularet-per-aplikim.aspx>

VËREJTE: Projektet të cilat nuk i kanë të bashkangjitura dokumentet sipas kërkesës si dhe projektet e palëve të cilët nuk kanë përmbyllur projektet nga fazat paraprake nuk do të merren parasysh nga Komisioni për shqyrtimin e kërkesave.

Për çdo informatë shtesë ju lutem na shkruani në kultura.pr@rks-gov.net